



**Për: Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës**

**Nga: Halil Tolaj – Drejtor i Drejtoratit për inspekcione**

**Lënda: Raport i punës së Drejtoratit për Inspekcione për gjashtëmujorin e dytë 2023.**

Në Kuadër të Drejtoratit edhe gjatë këtij gjashtëmujori kanë qenë të sistemuar Inspektori i Tregut, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë mbi shërbimet e Veçanta), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht ishte edhe shef i inspektorëve, e për shkak të moshës së pensionimit i njëjti është pensionuar me 16.11.2023.

Drejtorati për Inspekcione i Komunës së Deçanit gjegjësisht inspektorët e këtij Drejtorati, edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit kalendarik 2023 kanë kryer punët dhe detyrat e punës mbështetur në Ligjet dhe aktet nënligjorë si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2023.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente. Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore, ndërtimet pa leje apo në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në mënyrë permanente është bërë kontrolli i therjes së kafshëve në thertoret e licencuara.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe të mbrojtjes në punë.

Janë bërë kontrolle sipas kërkesës së Policisë së Kosovës (me të cilët ekziston një bashkëpunim mjaft i mirë), posaçërisht për mallrat e hasura në transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse, mosrespektimin e orarit të punës sidomos nga subjektet hoteliere, por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa rregullsitë e hasura të subjektet tregtare sidomos nga lëmi i çmimeve dhe afati i skadimit të artikujve ushqimor.

Janë kryer edhe punë tjera sipas fushe veprimtarisë të secilit nga inspektorët.  
Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:


Inspektor i	Kontroll inspektues e në teren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektues e në teren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik	Procesverbal e të hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktivendime	Procesverbal e për inspektim të lejeve ndërtimore	Procesverbal e për inspektim të lejeve mjedisore	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	34	47	47	4			2
I Ndërtimit	24	10	24	3	19		/
I Mbrojtjes së Ambientit	18	5	13	/		6	/
I Veterinës	31	38	38	/			/
I bujqësisë	4	5	5	/			/
<b>Gjithsejt:</b>	<b>111</b>	<b>105</b>	<b>127</b>	<b>7</b>	<b>19</b>	<b>6</b>	<b>2</b>

**Kërkesë:** Kërkoj nga Kryetari i Komunës që të kërkoj nga Zyra e personelit, zhvillimin e procedurave për rekrutimin gjegjësisht plotësimin e vendit të lire të punës Inspektor i Bujqësisë i cili njëkohësisht ka qen edhe shef i drejtoratit për shkak të shkuarjes në pension të zyrtarit të deritanishëm, apo të plotësoj vendin e punës së Inspektorit të ndërtimit i cili mbulohet me kontratë mbi shërbimet e veçanta.



**Drejtori**

*Hakil Tolaj*  
Hakil Tolaj


 REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA E DECANIT - DECAN MUNICIPALITY  
 Drejtori i Inspektoratit 3964  
 02 30.01.24  
 DECAN DECAN